



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА  
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 12/19), neni 40 paragrafi 2 i Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsioni, duke vepruar në rastin e formuar pas kërkesës së paraqitur nga parashtruesi i njohur, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme KSHPK), në seancën e 83-të të mbajtur më 27.02.2023 ka miratuar si në vijim.

### VENDIM

Denoncimi i regjistruar me numër 12-4937/1 datë 12.05.2022, kundër personave përgjegjës në -----, HIDHET POSHTË .

KSHPK-ja konstatoi se, në përputhje me Ligjin për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, nuk ka elemente për veprim kompetent për rastin në fjalë për arsye se vlerësoi se organi tjetër është kompetent për të vepruar.

Lënda me numër 12-4937/1 të datës 12.05.2022 të mbyllet dhe të arkivohet .

Vendimi i KSHPK-së, në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

### Arsyetim

Më datë 12.05.2022, nga një parashtrues i panjohur është dorëzuar denoncim ndaj personave përgjegjës në Auto Servis ----- nga ----- dhe është formuar lënda me numër 12-4937/1 datë 12.05.2022.

Në denoncim parashtruesi thekson se Auto srevisi i përmendur ka punuar pa respektuar disa dispozita ligjore.

Gjegjësisht, thuhet se Auto Servis ----- i cili ndodhej në lokacionin në Komunën -----, ----- nuk kishte mbishkrim të përshtatshëm për titullin e personit juridik; se ai ishte i regjistruar në një adresë ndërsa aktivitetet e punës kryheshin në një vend tjetër; më tej, se ka qenë punëtor i cili nuk ka kryer veprimtari pune në personin juridik të përmendur, por është regjistruar vetëm për sigurimin e viteve të shërbimit; nuk janë respektuar dispozitat ligjore të Ligjit për Marrëdhëniet e Punës në lidhje me orarin e caktuar të punës, por se puna është bërë çdo ditë dhe pas më shumë se orari i caktuar i punës etj.

Parashtruesi thekson se zyrtarët e KSHPK-së kanë kryer kontroll në punën e Auto servilit dhe se kanë konstatuar se për një të siguruar është paguar vetëm për kontributet e sigurimit shëndetësor dhe pensional, por që të ardhurat e mbetura të cilat nuk janë tatuar nuk janë përcaktuar, andaj kërkon nga KSHPK që të kryejë sërish kontrollin dhe të konstatojë deri në fund të gjitha parregullsitë.

Pas shqyrtimit të pretendimeve në fjalë, KSHPK-ja konstaton se në bazë të kompetencave ligjore, KSHPK-ja as nuk ka kompetencë për të kryer kontrollin siç përshkruhet në pretendimet në fjalë dhe as nuk është kryer ndonjëherë kontroll mbi punën e Auto servisit - ----, gjegjësisht në rastin në fjalë bëhet fjalë për pretendimet që nuk janë objekt i veprimit kompetent të tij, por janë pretendime për një çështje që kanë të bëjnë me veprimin kompetent të një organi tjetër kompetent, pas së cilës u gjykua se ka nuk ka elemente për veprim kompetent për rastin në fjalë.

Duke marrë parasysh sa më sipër, KSHPK-ja vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Përgatiti: Mr. K.Z  
Miratoi: Mr. SH.S

KOMISIONI SHTETËRORE  
PËR PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT  
Nënkryetar  
**Katica Nikolovska**